VENDIM
Nr.206, datë 7.4.2005

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 30 800 M², PJESË E REPARTIT USHTARAK NR.4020, RINAS NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 30 800 m^2, në zonën kadastrale 3096 të fshatit Qerekë (parcela 34), pjesë e repartit ushtarak nr.4020, Rinas, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit "Nënë Tereza", Tiranë.

2. Sipërfaqja 30 800 m^2, pjesë e pronës me numër rendor 794, "Reparti ushtarak nr.4020, Rinas", sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



RINAS
155
189
QERREK
3096
23/1
172
173
33/11
33/10
33/9
33/8
33/7
33/6
33/5
33/4
33/3
33/2
33/1
33/12
34
32/5
32/3
32/7
32/8
32/45
32/9
32/10
32/11
32/12
32/13
32/14
32/16
32/17
32/18
32/19
32/20
32/21
32/22
32/23
32/24
32/25
32/27
32/28
32/30
32/31
32/32
32/33
32/34
32/35
32/36
32/37
32/38
32/39
32/40
32/41
32/42
32/43
32/47
32/2
28
37
40/28
40/27
40/26
40/25
40/24
40/23
40/22
40/21
40/20
44/39
44/38
44/37
44/36
44/43
44/47
43/1